

20230971827

Bazuar në nenin 53 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192 /15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/ 21, 150/22 dhe 236/22), ministri i Punës dhe Politikës Sociale miratoi

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES MBI KUSHTET MË TË PËRAFËRTA DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË TË DREJTAVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E GJENDJES SË TË ARDHURAVE, PRONËSISË DHE TË DREJTAVE PRONËSORE TË AMVISËRISË DHE FAMILJES PËR TË DREJTAT E SHITESËS FËMIJËRORE, SHITESËS PRINDËRORE PËR FËMIJË DHE SHITESËS PËR ARSIM

Neni 1

Në Rregulloren mbi kushtet më të përafërta dhe mënyrën e realizimit të të drejtave për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe për përcaktimin e gjendjes së të ardhurave, pronësisë dhe të drejtave pronësore të amvisërisë dhe familjes për të drejtat e shtesës fëmijërore, shtesës prindërore për fëmijë dhe shtesës për arsim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 109/19, 116/19, 234/20, 222/21 dhe 24/22), neni 12 ndryshon si vijon:

„(1) Nëse në konstatimin dhe mendimin për vlerësim funksional të lëshuar nga Shërbimi për Vlerësim Funksional pranë Entit Publik Shëndetësor – Shtëpia e Shëndetit Shkup (në tekstin e mëtejme: Shërbimi) është rekomanduar ekzaminim respektivisht vlerësim, parashtrohet konstatim dhe mendim i ri për vlerësim funksional.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, Qendra për punë sociale jo më vonë se një muaj para përfundimit të datës së kontrollit ekzaminues, gjegjësisht vlerësimit, me shkrim e njofton shfrytëzuesin e të drejtës se duhet të dorëzojë në kohë konstatimin dhe mendimin për vlerësimin funksional.

(3) Nëse konstatimi dhe mendimi i ri nga paragrafi (1) i këtij neni nuk parashtrohet edhe pas njoftimit me shkrim nga paragrafi (2) i këtij neni, shfrytëzimi i së drejtës në shtesë të veçantë ndërpritet, përveç në rastet kur për shkaqe të arsyeshme (sëmundje ose trajtim i fëmijës ose për shkaqe të arsyeshme Shërbimi i Vlerësimit Funksional nuk ka mundur të kryejë në kohë ekzaminimin e kontrollit-vlerësimit), përfituesi i së drejtës nuk ka mundur t'i dorëzojë ato në kohë, me ç'rast procedura ndërpritet deri në miratimin e një konstatimi dhe mendimi të ri për vlerësimin funksional i lëshuar nga Shërbimi i Vlerësimit Funksional.

(4) Për shkaqe të arsyeshme nga paragrafi (3) i këtij neni, shfrytëzuesi i së drejtës e njofton me shkrim Qendrën kompetente për punë sociale jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së shkaqeve të arsyeshme dhe dorëzon dëshmi (vërtetim) për shkaqe të arsyeshme të lëshuar nga Shërbimi për vlerësimin funksional”.

Neni 2

Në nenin 13 paragrafi (3) fjalët "nevojat specifike që ka pengesa në zhvillimin fizik ose mendor ose pengesa të kombinuara në zhvillim" zëvendësohen me fjalët "aftësia e kufizuar".

Në paragrafin (5) fjalët "nevojat specifike që ka pengesa në zhvillimin fizik ose mendor ose pengesa të kombinuara në zhvillim" zëvendësohen me fjalët "aftësia e kufizuar".

Neni 3

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 11-3574/1
3 maj 2023
Shkup

Ministrja e Punës dhe
Politikës Sociale,
Јованка Тренчевска, d.v.